



WORKSHOP

Hapësirë Kibernetike e sigurt për fëmijët



Përmbajtja e dëmshme për fëmijët në interneti nje risi ne

Problem i theksuar për fëmijët sot gjatë përdorimit të internetit është se shpeshherë ata mund të hasin në përmbajtje të papërshtatshme të gjate lundrimit ne internet.

Ose faqe te dedikuara vetëm për të rritur dhe nuk ka mekanizëm ndalues që fëmijët të mos mund të qasen në këto uebfaqe.

Në Shqipëri, ka disa ligje dhe dokumente ligjore që trajtojnë këtë çështje. Ka disa dokumenta dhe dispozita ligjore dhe ligje qe kanë për qëllim të mbrojnë fëmijët nga përmbajtja e dëmshme dhe e papranueshme në internet duke vendosur dënime për shkelësit dhe duke parandaluar përhapjen e përmbajtjeve të tilla.

Ata gjithashtu synojnë të promovojnë një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët për të shfrytëzuar internetin dhe teknologjinë dixhitale

Dispozitat ligjore dhe dokumente strategjike

- ▶ Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës (AKDF) 2021 – 2026,
- ▶ Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" dhe vkm udhezime
- ▶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë neni 117 Dispozita për materialet pornografike që përfshijnë fëmijë është veçanërisht e rëndësishme për të mbrojtur ata nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual. Kurse për prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, shitjen, importimin ose mbajtjen e materialeve pornografike që përfshijnë fëmijë, dënimet përfshijnë burgim nga tre deri në dhjetë vjet për ata që janë të përfshirë
- ▶ LIGJ nr. 25/2024 për sigurinë kibernetike ndërmerr masa të nevojshme, bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve për krijimin e një mjedisi online të sigurt kibernetik në Republikën e Shqipërisë.

- ▶ **Vendimi Nr. 930, datë 18.11.2015**” Strategjia kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë masat për parandalimin e përmbajtjeve të rrezikshme në internet që mund të ndikojnë fëmijët në mënyrë negative.
- ▶ Ligji nr.155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat dhe kufizimet për lojërat e fatit në Shqipëri, duke përfshirë dispozita për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtjet e pa përshtatshme në internet.
- ▶ Ligji për arsimin parauniversitar I NDRySHUAR
- ▶ VKM e ligjit Nr. 18/2017 Nr.465, date 03.07.2019 “Pë masat për mbrojtjen e fëmijeve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”
- ▶ UDHËZIM I PËRBASHKËT nr. 658, datë 23.9.2019”Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës,në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij

Rëndësia e Përcaktimeve Ligjore

1. Korniza ligjore Ndhmon Institucionet dhe ofruesit e shërbimeve në identifikimin dhe **bllokimin e përmbajtjeve** të dëmshme dhe te paligjshme
 2. **Siguron** autoriteteve **një bazë ligjore për veprim dhe** për të ndërhyrë dhe për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtjet që cenojnë dinjitetin dhe të drejtat e tyre.
- **Edukimi dhe ndërgjegjësimi:** Ndhmon në edukimin e prindërve, mësuesve dhe vetë fëmijëve për rreziqet që përmban interneti dhe mënyrat për të mbrojtur

Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"

Ligji Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”. Për herë të parë kemi një nen të veçantë në këtë ligj (nenin 27) i cili flet për mbrojtjen e fëmijës nga aksesimi në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet. Për herë të parë kemi bërë një përpjekje për të përkufizuar se çdo të thotë “**përmbajtje të dëmshme për fëmijën**” ku përfshihen të gjitha ato pamje, imazhe dhe çdo material tjetër që qarkullon në internet dhe që cënon dinjitetin dhe të drejtat e fëmijës. (Pika 11 e nenit 3

VKM e ligjit Nr. 18/2017 Nr.465, datë 03.07.2019 “Pë masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesimi në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet” përcakton: “**Përmbajtje e paligjshme**” është çdo pamje, imazh dhe material tjetër, që qarkullon në internet, dhe që, sipas legjislacionit në fuqi, është i ndaluar dhe pasi përbën vepër penale.

ASHDMF shqyrton çdo raportim apo rast të konstatuar lidhur me faqe/materiale me përmbajtjetë paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët në internet dhe: në bashkëpunim me Autoritetet përgjegjëse merr masat përkatëse për bllokimin e tyre,

Çfarë është përmbajtja e dëmshme në internet?

Përmbajtja e dëmshme mund të krijohet nga **përdoruesit ose të krijohet duke përdorur Inteligjencën Artificiale (AI)**. Ka prova në rritje se AI po përdoret për të gjeneruar imazhe të pahijshme të fëmijëve. Imazhet e abuzimit seksual të fëmijëve janë të paligjshme në MB, pavarësisht se si prodhohen.

Mund të variojnë në forma dhe lloje të ndryshme. Këtu janë disa nga kategoritë kryesore të përmbajtjeve të tilla:

1. Përmbajtje të dhunshme

- Video dhe lojëra me skena të dhunshme: Këto mund të nxisin sjellje agresive ose të shkaktojnë frikë dhe ankth.
- Përmbajtje që promovon torturën, vrasjen ose vetëvrasjen: Mund të jetë tronditëse dhe traumatike për fëmijët.

2. Përmbajtje seksuale dhe pornografike

- Përdorimi i materialeve pornografike: Mund të shtrembërojë perceptimet e fëmijëve mbi marrëdhëniet dhe seksualitetin.
- Seksualizimi i të miturve: Promovon ide të rrezikshme dhe mund të çojë në shfrytëzimin seksual.

3. Gjuhë urrejtjeje dhe diskriminim

- Materiale që promovojnë racizmin, seksizmin, homofobinë, ose format e tjera të urrejtjes: Mund të nxisë sjellje diskriminuese dhe ndjenjë të ulët të vetëvlerësimit te fëmijët që i përjetojnë këto forma të urrejtjes.
- *Bullizmi kibernetik*: Komente apo mesazhe që ofendojnë dhe poshtërojnë të tjerët.

Çfarë është përmbajtja e dëmshme për fëmijet në internet?

► 4. Përmbajtje mashtruese dhe dezinformim

- *-Lajme të rreme dhe teori konspirative:* Mund të çojnë fëmijët të kenë besime të rreme dhe të zhvillojnë një pamje të shtrembëruar të botës.
- *Skema mashtruese dhe phishing:* Mund të përfshijnë fëmijët në aktivitete të rrezikshme ose t'i bëjnë ata viktima të mashtrimeve financiare.

► 5. Përmbajtje që promovon varësi të dëmshme

- *Materiale që promovojnë drogën dhe alkoolin:* Mund të inkurajojnë sjellje të rrezikshme dhe të paligjshme.
- *Lojëra të fatit dhe bixhoz:* Mund të krijojnë varësi dhe të sjellin pasoja financiare dhe psikologjike.

► 6. Përmbajtje që përfshin ndërveprime me të panjohur

- *Rrjete sociale dhe platformat e bisedave:* Fëmijët mund të jenë në rrezik nga predatorët online ose individë me qëllime të këqija.
- *Kërkesa për informacione personale:* Mund të çojë në shfrytëzim ose abuzim.

► 7. Përmbajtje që promovon vetëdëmtimin dhe vetëvrasjen

- *Faqe dhe grupe që nxisin vetëdëmtimin:* Mund të ndikojnë negativisht në shëndetin mendor të fëmijëve.
- *Materiale që romantizojnë ose glorifikojnë vetëvrasjen:* Mund të rrisin rrezikun e vetëvrasjes tek fëmijët.

► 8. Përmbajtje e papërshtatshme për moshën

- *Lojëra dhe filma për të rritur:* Mund të përmbajnë tema dhe skena që nuk janë të përshtatshme për fëmijët dhe mund të shkaktojnë konfuzion ose frikë.
- *Diskutime për tema të ndjeshme dhe komplekse:* Tema si politika, religjioni, ose çështje të tjera të ndjeshme mund të jenë të papërshtatshme për fëmijët e vegjël.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë - Neni 117:

- ▶ Neni 117 i Kodit Penal është një dispozitë kyçe për mbrojtjen e të fëmijëve nga rreziqet e pornografisë, duke vendosur dënime për shkelësit e këtyre rregullave. Qëllimi kryesor i këtij neni është:
- ▶ **Mbrojtja e fëmijëve:** Dispozita për materialet pornografike që përfshijnë fëmijë është veçanërisht e rëndësishme për të mbrojtur të miturit nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual.
- ▶ **Prudhomme dhe shpërndarja e materialeve pornografike me fëmijë:** Ky është një krim më i rëndë dhe mbart një dënim shumë më të ashpër, duke reflektuar seriozitetin e veprës penale. Dënimet përfshijnë burgim nga tre deri në dhjetë vjet për ata që janë të përfshirë në prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, shitjen, importimin ose mbajtjen e materialeve pornografike që përfshijnë fëmijë.



Ndikimi i permbajtjeve te demshme dhe te papershtatshme në internet tek femijet

► - Ndikimi emocional dhe psikologjik:

- **Ankthi dhe depresioni:** Përmbajtjet e dëmshme, siç janë pamjet tronditëse ose të frikshme, mund të shkaktojnë ankth dhe depresion te fëmijët.
- **Stresi dhe traumë:** Ekspozimi ndaj dhunës, abuzimit ose përmbajtjeve të tjera tronditëse mund të shkaktojë stres post-traumatik.
- **Vetëbesim i ulët:** Përmbajtjet që promovojnë standarde jorealiste të bukurisë ose suksesit mund të dëmtojnë vetëvlerësimin dhe vetëbesimin e fëmijëve.

► Ndikimi social:

- **Izolimi social:** Fëmijët që kalojnë shumë kohë në internet mund të izolojnë nga bashkëmoshatarët dhe të kenë vështirësi në krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve sociale.
- **Sjellje agresive:** Përmbajtjet e dhunshme mund të normalizojnë sjelljet agresive dhe të çojnë në konflikte sociale dhe sjellje antisociale.

► Ndikimi edukativ:

- **Performanca akademike:** Kalimi i tepërt i kohës në internet mund të ndikojë negativisht në përqendrimin dhe performancën akademike të fëmijëve.
- **Informacion i gabuar:** Fëmijët mund të ekspozohen ndaj dezinformimit dhe propagandës, që mund të dëmtojë aftësitë e tyre për të menduar në mënyrë kritike.

► Ndikimi fizik:

- **Probleme me shikimin:** Kalimi i gjatë i kohës para ekranit mund të shkaktojë lodhje të syve dhe probleme të tjera shikimi.
- **Mungesa e aktivitetit fizik:** Kalimi i shumtë i kohës në internet mund të çojë në një mënyrë jetese të palëvizshme, duke rritur rrezikun për obezitet dhe probleme të tjera shëndetësore.

► Ndikimi në sjelljen seksuale:

- **Ndikimi negativ në zhvillimin seksual:** Ekspozimi ndaj përmbajtjeve pornografike mund të ndikojë në mënyrë të gabuar në zhvillimin e qëndrimeve dhe sjelljeve seksuale te fëmijët.
- **Rritja e rrezikut të abuzimit:** Fëmijët që ekspozohen ndaj përmbajtjeve të dëmshme seksuale janë më të rrezikuar për t'u bërë viktima të abuzimit seksual.

► Varësia nga interneti:

- **Varësia teknologjike:** Fëmijët mund të zhvillojnë varësi ndaj internetit dhe teknologjisë, duke ndikuar negativisht në jetën e tyre të përditshme dhe marrëdhëniet me të tjerët.

Si bien në kontakt fëmijët ndaj përmbajtjeve të dëmshme në internet?

- ▶ Ka shumë mënyra se si fëmijët dhe të rinjtë mund të shohin përmbajtje të dëmshme në internet. Platformat online përdorin algoritme që sugjerojnë përmbajtje të re bazuar në atë që është e njohur ose me atë që përdoruesit kanë ndërvepruar më parë. Kjo do të thotë që përmbajtja e sugjeruar mund t'i çojë shpejt fëmijët dhe të rinjtë drejt përmbajtjeve që mund të mos jenë të përshtatshme për moshën.
- ▶ Fëmijët dhe të rinjtë gjithashtu mund të hasin në përmbajtje aksidentalisht, kur bëjnë diçka tjetër në internet. Atyre mund të dërgohen përmbajtje të dëmshme nga të tjerët. Ose mund ta kërkojnë në mënyrë aktive – për shembull, nëse po eksplorojnë seksualitetin e tyre në internet, mund të hasin në përmbajtje të dëmshme dhe të papërshtatshme për moshën ose skenën.

Bashkëpunimi institucional mes NJMF dhe strukturave arsimore

- ▶ UDHËZIM I PËRBASHKËT nr. 658, datë 23.9.2019”Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës,në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij
- ▶ Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijës, në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij.

Raportimi I rasteve, roli I shkolles dhe mesueseve

- ▶ Çdo mësues, mësuesndihmës dhe çdo punonjës i institucionit arsimor (psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari), në rast se në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstaton një nxënës që është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij, ka detyrimin të **raportojë** pranë drejtorisë së institucionit arsimor, institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar (në vijim “IAVPAP”), organeve të Policisë së Shtetit dhe strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijës.
- ▶ Mësuesit, mësuesit ndihmës dhe punonjësit e institucionit arsimor raportojnë rastet e identifikuar pranë drejtorisë së institucionit arsimor dhe IAVPAP-së, me çdo mjet komunikimi, me telefon, e-mail, me postë, në formë shkresore etj.
- ▶ Drejtori i institucionit arsimor dhe drejtori i IAVPAP-së, brenda 24 orëve nga identifikimi, raportojnë rastin pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijës me çdo mjet komunikimi
- ▶ PMF, marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, për të lehtësuar raportimin.

Ndjekja e rasteve nga PMF dhe puna me prindin

- ▶ PMF, pas marrjes së raportimit, verifikon informacionin e dhënë dhe vlerësimin fillestar të rastit.
- ▶ Me pas, PMF njofton ASHDMF e cila sipas ligjit nr. 18/2017 dhe ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike” i kërkon autoritetit përgjegjës të marrë masa për bllokimin e aksesit në rrjetet kompjuterike ose ato të informacionit dhe në faqet e internetit.
- ▶ PMF organizon takime këshilluese, ndërgjegjësuere me prindërit dhe fëmijën.
- ▶ PMF, marrin masa për vendosjen e njoftimeve me informacionin e kontaktit në të gjitha mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, për të lehtësuar raportimin.

Në rastin kur vlerësohet se janë të pamjaftueshme seancat e këshillimit ndaj prindërve të fëmijës, PMF në bashkëpunim me NJQVR marrin masa për hartimin e planit për **Aftësim Prindëror** i cili përmban masa për detyrimin e prindërve për të ndjekur kurse për aftësim prindëror duke marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Ruajtja e konfidencialitetit të çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës

- ▶ Të gjithë personat, të cilët kanë detyrim për raportim sipas këtij ligji, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ▶ Punonjësit e çdo strukture, të cilat marrin raportimin dhe ata që do të ndjekin çështjen e raportuar, kanë detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin e çështjes dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijës dhe të personit të dyshuar për abuzim.
- ▶ Raportimi bëhet nëpërmjet formularit të raportimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje sipas aneksit 2, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

Roli I prindit dhe disa masa për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtjet e dëmshme dhe të papërshtatshme:

- ▶ **Te Përdorin kontrollin prindëror:** Shumë pajisje dhe shërbime online ofrojnë mjete për të kufizuar qasjen në përmbajtje të papërshtatshme.
- ▶ Gjurmojne vendndodhjen e smartfonit dhe ndalojnë funksionimin e disa programeve në kohën që dëshironi.
- ▶ **Monitoroni aktivitetin online:** Mbikëqyrni faqet që fëmijët vizitojnë dhe aplikacionet që përdorin.
- ▶ **Diskutoni rreziqet e internetit:** Edukoni fëmijët mbi rreziqet dhe inkurajoni ata të flasin me ju nëse ndihen të shqetësuar ose të frikësuar nga ndonjë përmbajtje që hasin online.
- ▶ **Vendosni rregulla të qarta:** Vendosni dhe mbani rregulla të qarta mbi përdorimin e internetit dhe pajisjeve elektronike.
- ▶ Bëhuni edhe ju një shembull i mirë në sy të fëmijës. Mos e përdorni celularin në tavolinën e ngrënies dhe mos e përdorni gjatë ngarjes së makinës.
- ▶ Vendosni prizat e karikimit në dhomën e ndenjes. Celularët duhet të rrinë larg dhomës së fëmijëve dhe ata nuk do e përdorin celularin gjatë natës deri në orët e para të mëngjesit.